



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025 | Nr: 126 | Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 36 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Vangjel Tavo**
Kryetar për Bashkinë Himarë

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nëpërmjet shpalljes së procedurave të prokurorit “Rikonstruksioni i Rrugës së Fshatit Tërbaç me Rrugën Nacionale”

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 36 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna:

- *Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Himarë;*
- *Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur;*

Data: 20.02.2025

Nr: 126
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 36 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

- *Objekti i kontratës: Rikonstruksioni i Rrugës së Fshatit Tërbaç me Rrugën Nacionale;*
- *Numri i referencës së procedurës: REF-27014-10-29-2024;*
- *Fondi limit: 269,166,667 lek pa TVSH;*
- *Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj;*
- *Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga cili nisin afatet e ankimit: 3 Shkurt 2025.”*

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Vangjel Tavo, Kryetar për Bashkinë Himarë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI